



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Received / Delivered		12.04.2022		2 viti god. years	
Organ / Njësia Organ / Jedinstvo Org. Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity		
SKIDARSKA	2040/2022		1/67		



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.152/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.152/2022 të datës 22.02.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted] të cilin me autorizim e përfaqëson avokat [redacted] me adresë [redacted] kundër heshtjes administrative të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës lidhur me kërkesën e ankuesit të datës 27.12.2021, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 12.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.152/2022 e datës 22.02.2022 e parashtruar nga ankuesi [redacted]
- II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr.39/2022 i datës 15.02.2022 i Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] nëpunës civil në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, përmes përfaqësuesit me autorizim më datë 22.02.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës lidhur me kërkesën e ankuesit të datës 27.12.2021 për pezullim të marrëdhënies së punës/vazhdim të pushimit pa pagesë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datë 24.02.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (tutje MPJD), ndërsa kjo e fundit më datë 04.03.2022 ka dërguar përgjigjen në ankesë së bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritore administroj këto prova: Ankesën me numër të protokollit 928/2022 të datës 22.02.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 28.01.2022 për lejimin e përfaqësimit; Vendimin me numër Nr. ref. 71/2021 të datës për lejimin e pushimit pa pagesë; Emalin e datës 27.12.2021; Kërkesën e datës 27.12.2021; Emalin e datës 11.01.2022; Emalin e datës 24.01.2022; Emalin e datës 28.01.2022; Emalin e datës 27.12.2021; Vendimin me numër të protokollit 2-0/415 i datës 15.02.2022; Vërtetimin e datës 22.12.2021; Urdhrin për pagesë ndërkombëtare të datës 26.11.2021; kërkesën me numër të protokollit 20-393 të datës 11.02.2022; kërkesën e datës 19.03.2021 për pezullim të pozitës; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 981/2021 të datës 24.02.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 1188/2022 të datës 04.03.2022; Emalin e datës 21.03.2021; Emalin e datës 18.02.2022; Emalin e datës 28.01.2022; Emalin e datës 28.01.2022; Emalin e datës 29.01.2022; Emalin e datës 27.12.2021; Emalin e datës 06.01.2022; Emalin e datës 27.12.2021; kërkesën e datës 28.01.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi shqyrtimit dhe analizimit të shkresave materiale të lëndës, konstatoi se ankesa e ankuesit *është e pabazuar, sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës respektivisht sipas Vendimit Nr.ref.71/2021 të datës 22.03.2021 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së, ankuesit i është lejuar pushimi pa pagesë në kohëzgjatje prej një (1) viti përkatësisht nga data 23.03.2021 deri me 23.03.2022 për arsye të përfundimit të studimeve të doktoratës në fushën e Shkencave Politike në Universitetin e Evropës Juglindore.

Ankuesi me datë 27.12.2021, parashtron kërkesë të Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më kërkesë që ti vazhdohet pushimi pa pagesë deri në vitin 2024 me sqarimin se i njëjti ka transferuar studimet në Universitetin e Sarajevës në Qendrën e Studimeve Ndërdisciplinore në Programin e Studimeve Globale. Ankuesi serish me datë 11.01.2022 parashtron të njëjtën kërkesë pranë organit të punësimit.

Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me datë 15.02.2022 ka nxjerrë vendimin Nr.39/2022 përmes të cilit ka refuzuar kërkesën e ankuesit lidhur vazhdimin e pushimit pa pagesë, duke obliguar të njëjtin që të paraqitet në vendin e punës nga data 24.03.2022.

Në ankesën e parashtruar në Këshill, ankuesi pretendon se pasi që organi i punësimit nuk e ka njoftuar brenda 45 ditësh ankuesin lidhur me kërkesën e tij të datës 27.12.2021 dhe se po ashtu nuk e ka njoftuar të njëjtin me shtyrje të afatit për vendosje të kërkesës në fjalë, atëherë është plotësuar kushti i paraparë më nenin 100 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative respektivisht duhet të aplikohet *instituti të aktit administrativ i miratuar në heshtje*. Me tej shton se Vendimi Nr. 39/2022 i datës 15.02.2022 i Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së, është i vonshëm dhe si i tillë është i paligjshëm pasi që i njëjti është nxjerr jashtë afatit ligjor. Kërkon që Këshilli ta aprovoj ankesën si të bazuar, të anuloj Vendimin Nr.39/2022 të datës 15.02.2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së dhe të obligohet Sekretari i Përgjithshëm i MPJD-së që të nxjerrë vërtetim me shkrim për miratimin e kërkesës së ankuesit të datës 27.12.2021 bazuar në institutin e aktit administrativ të miratuar në heshtje.

Lidhur me pretendimin ankimor se është plotësuar kriteri i institutit të aktit administrativ të miratuar në heshtje, Kolegji ka analizuar nenin 100 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilin është përcaktuar se: *Nëse pala ka kërkuar nxjerrjen e një akti*

administrativ të shkruar dhe organi publik nuk e njofton palën për aktin administrativ brenda afatit fillestar dhe nuk njofton shtyrjen apo nuk njofton për aktin brenda afatit të shtyrë, sipas nenit 98 gjegjësisht 99 të këtij Ligji, kërkesa e bërë nga pala do të vlerësohet e pranuar në tërësi dhe akti administrativ i kërkuar nga pala do të vlerësohet të jetë miratuar (në vijim: "akti administrativ i miratuar në heshtje"), rrjedhimisht Kolegji në vështrim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në provat e lëndës ka konstatuar se ankuesi ende pa përfunduar afati ligjor për shqyrtimin dhe vendosjen e kërkesës së tij të datës 27.12.2021, serish më datë 11.01.2022 parashtron kërkesë të njëjtë pranë organit të punësimit, përkatësisht me këtë veprim administrativ ankuesi ka ndërprerë afatin e vendosjes lidhur me kërkesën e datës 27.12.2021, dhe si rrjedhojë ka iniciuar procedurë të re administrative për çështje të njëjtë juridike-administrative, kështu që nisur nga ky fakt rezulton se Vendimi Nr.39/2022 i datës 15.02.2022 i zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së është nxjerrë brenda afatit ligjor të përcaktuar më nenin 98 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. E në këtë kuptim Kolegji vlerëson së është i pa bazuar pretendimi ankimor si me lartë.

Në funksion të shqyrtimit të ligjshmërisë së Vendimit Nr.39/2022 të datës 15.02.2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së, dhe duke marr parasysh faktin se ankuesi kërkesën e tij për vazhdim të pezullimit të marrëdhënies së punës për arsye të studimeve të doktoratës, e mbështet në bazën ligjore sipas nenit 55 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenit 56 paragrafi 1 nënparagrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka analizuar me vëmendje nenin 55 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin është përcaktuar se: *Pezullimi është ndërprerja e përkohshme e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil, i cili bëhet: 1.1. sipas detyrës zyrtare; apo 1.2. me kërkesë të nëpunësit civil..* si dhe nenin 56 paragrafi 1 nënparagrafi 1.8 po të këtij ligji ku parashihet se: *Nëpunësi civil pezullohet, sipas detyrës zyrtare të organit përkatës të punëdhënësit, në rastet si në vijim: 1.8. gjatë ndjekjes së ndonjë programi arsimimi apo trajnimit për nevojat e institucionit për periudhën që ndjek këtë program me shprehje nga puna; nga dhe është vlerësuar së pezullimi i marrëdhënies së punës mbi këtë bazë ligjore i referohet vetëm ndjekjes së programeve trajnuese apo arsimore që janë vlerësuar si me interes për institucionin, andaj, meqenëse në rastin në fjalë organi i punësimit nuk e ka vlerësuar si të nevojshëm për institucionin përfundimin e programimit të doktoratës nga ankuesi, duke cilësuar njëkohësisht se studimet e doktoratës nuk janë kërkesë e obligueshme për vendin e punës të ankuesit, Kolegji konstatoi së është i pa bazuar pretendimi ankimor që të anulohet Vendimi Nr.39/2022 i datës 15.02.2022 i Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së.*

Po ashtu Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen lidhur me vendosjen meritore të kësaj çështje, ju referua edhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, konkretisht nenit 14 me të cilin theksohet se: *Zyrtari publik gëzon të drejtën për pushim pa pagesë në pajtim me dispozitat e Ligjit të punës. 2. Në raste të veçanta zyrtari publik mund të përfitojë pushim pa pagesë, për nevoja të: 2.1. ngritjes apo arsimimit më të lartë profesional...ndërlidhur me këtë neni 40 i Ligjit Nr.03/L-212 të Punës ka paraparë se: Në bazë të kërkesës së të punësuarit, punëdhënësi mund të lejojë që i punësuarit të mungojë nga puna pa kompensim të pagës. 2. Për kohën e mungesës në punë pa kompensim të pagës nga paragrafi 1. i këtij neni, të punësuarit i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës, përveç të drejtave të cilat burojnë nga pagesa e detyrueshme e kontributeve nga ana e të punësuar, gjegjësisht ashtu siç u konstatua me lartë, rezulton se mbetet në diskrecion të organit të punësimit që të lejoj pushim pa pagesë për nëpunësin civil lidhur me ndjekjen e programe arsimore dhe të ngritjes profesionale që janë të nevojshme për institucionin.*



Andaj, siç u tha me sipër, Kolegji pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.152/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse



Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në MPJD;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në MPJD; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

